



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Doretuar Primijsno/Prodato Received/Delivery	29.06.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org/Unit	Nr Prot H: Prot Prof No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHCK	3803/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.483/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Sabile Avdyli- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.483/2022 të datës 26.05.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit Komuna e Skenderajt në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të nenit 132 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjakshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim me datë 29.06.2022 mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.483/2022 e datës 26.05.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 26.05.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 3055/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të Komisionit Përzgjedhës për pozitën Specialist i Administrimit të Përgjithshëm me nr.ref. RN00008140 të konkursit të datës 10.02.2022 deri më datën 24.02.2022 i shpallur nga Komuna e Skenderajt.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullosës Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 01.06.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Skenderajt, ndërsa kjo e fundit me datë 17.05.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 3558/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me qëllim të vendosjes meritorë ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 26.05.2022 me numër protokoll 3055/2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Rezultatet e vlerësimit; Njoftim in datës 31.03.2022; Njoftim i datës 22.04.2022; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 17.06.2022 me numër protokoll 3558/2022 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/49; E-mail zyrtar i datës 31.05.2022; E-mail zyrtar i datës 27.05.2022 kërkesë për qasje në dokumente zyrtare; Rezultatet me shkrim; Testi individual; Pyetjet dhe përgjigjet; Diplomë e shkollës së mesme e datës 21.05.2004; Diplomë e datës 27.04.2017 Master e lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; Çertifikatë e datës 28.08.2019; Kopja e letërnjoftimit; Çertifikatë e datës 22.02.2015; Çertifikatë e datës 08.07.2013 e Master i Shkencave Juridike -Financiare; Diplomë e datës 22 qershor 2009 e lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës -Bachelor i Drejtësisë; Vendim mbi lejimin e shpalljes së konkursit për vendet e lira të punës i datës 17.01.2022 me nr.02-11/01-0002739/22; Kopja e konkursit; Vendimi për emërimin e anëtarëve të komisionit datës 16.03.2022; Rezultatet e vlerësimit Specialist i Administrimit të Përgjithshëm i datës 27.04.2022 ; Diplomë e shkollës së mesme 15.05.2014; Diplomë e datës 12.09.2019 me nr.6452 e lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; Çertifikatë e notave master-kushtetues administrativ e datës 15.11.2021; Çertifikatë e datës 31.10.2018; Çertifikatë ; Vërtetim i datës 18.01.2021 me nr.139; Letër reference e datës 26.04.2021; Vërtetim i datës 16.12.2021 dhe Rekomandim i datës 24.12.2021;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e palejuar, SEPSE:**

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Komuna e Skenderajt më datë 26.04.2022 ka njoftuar ankuesin për pikët e fituara në testin me shkrim dhe intervistës me gojë ka marrë 57,8, ndërsa kandidati fitues ka marrë 88 pikë.

Ankuesi kundër këtij procesi të pranimit nuk ka sjell asnjë dëshmi me të cilën dëshmohet që kundër këtij procesi ka bërë ankesë të brendshme në njësinë përgjegjëse siç parashihet me nenin 25 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtrorjë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual"*, ndërsa ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj siç parashihet me paragrafin 6 të këtij neni.

Bazuar në këtë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër një procesi të pranimit në shërbimin civil, parashtrorhet vetëm pas shterimit të procedurës së brendshme të ankesës tek organi përkatës siç parashihet me nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"1.Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtrorjë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli") . 2. Ankesa në Këshill parashtrorhet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që*

kundërshtohet", si rrjedhojë meqenëse nuk ka asnjë dëshmi që ankuesi të ketë parashtruar ankesë të brendshme tek organi i punësimit, atëherë sipas Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, kandidatit në procedurë të pranimit nuk i lejohet të parashtror ankesë drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pa i shterur procedurat e brendshme të ankesave, mbi këtë bazë ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është në kundërshtim me nenin 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *"Para parashtrimin të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe"*, po ashtu ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është në kundërshtim me nenin 125 paragrafi 1 dhe nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe si e tillë është e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda,A.nr.483/2022; datë 29.06.2022

Sabile AVDYLI



Zyrtarë i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryetarit të Komunës së Skenderajt;
- ❖ Udhëheqësit të Njesisë së Personelit në Komunën e Skenderajt;
- ❖ Arkivit të KPMSHCK- së.

